



Republika e Kosovës
Republika Kosova – Republic of Kosovo



Komuna e Mitrovicës Veriore
Opština Mitrovica Sever – Municipality of Mitrovica North

Org. Jedin. Org. Unit.	01	Nr. Prot. Br. Prot.	01-030/01-0008871/24
Nr. i faqeve Br. stranice No. pages	1	Data Datum Date	12/08/2024

Kryetari i Komunës.

Nr. _____ . Data: 12.08.2024.

Mitrovicë Veriore.

Bazuar në nenin 58 të Ligjit Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje lokale, neni 31 të Statutit të Komunës të datës 15.05.2014, Kryetari i Komunës së Mitrovicës Veriore, sjell këtë:

V E N D I M

(Për Emërimin e Zyrtarit Përgjegjës për Monitorimin e zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet StrayCoCo dhe Komunës së Mitrovicës Veriore)

1. Caktohet z. **[Redacted]** Zyrtar Përgjegjës për Monitorimin e Zbatimit të Marrëveshjes ndërmjet StrayCoCo dhe Komunës së Mitrovicës Veriore.
2. Zyrtari i emëruar sipas pikës një (1) të këtij Vendimi ka detyrat si:
 - 2.1 monitoron implementimin e **Marrëveshjes** të nënshkruar mes **Komunës së Mitrovicës Veriore** dhe **Fondacionit Zvicran Stray CoCo** me Nr. të protokollit **01-030/01-0008871/24** i datës **12.08.2024**;
 - 2.2 bashkëpunon me personat tjerë përgjegjës të angazhuar nga fondacioni Stray CoCo;
 - 2.3 përpilon Raporte javore dhe mujore për ecurinë e punëve të përfunduara dhe ato të cilat janë në proces.
3. Mandati i Zyrtarit të emëruar zgjatë deri në përfundimin e projektit sipas marrëveshjes.
4. Vendimi hyn në fuqi ditën e nënshkrimit.



Kryetar i Komunës së Mitrovicës Veriore

I dorëzohet:

- 1x1 Zyrës së Kryetarit
- 1x1 Zyrës Ligjore
- 1x1 z. **[Redacted]**
- 1x1 Fondacionit Stray CoCo
- 1x1 Arkivës



Republika e Kosovës Republika Kosovo - Republic of Kosovo Komuna e Mitrovicës Veriore Opština Mitrovica Sever - Municipality of Mitrovica North	
Org. Jedini Org. Unit.	01
Prot. N.	01-030/01-000 8871/24
№ faqeve Stranica № Pages	1
Data Datum Date	12.08.2024

**MARRËVESHJE MIRËKUPTIMI
PËR TRAJTIMIN E QENVE ENDACAK NË KOMUNËN E MITROVICËS VERIORE**

Palët Nënshkruese:

- Fondacioni StrayCoCo nga Zvicra, përfaqësuar nga znj. [REDACTED] (referuar si fondacioni)
- Komuna e Mitrovicës Veriore përfaqësuar nga z. **Erden Atiq**, Kryetar i Komunës (referuar si Komuna)

**Neni 1
Qëllimi**

Qëllimi i lidhjes së kësaj marrëveshje është realizimi i projektit për trajtimin human të qenve endacak në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore e që për impakt do të ketë zvogëlimin e numrit të tyre, me qëllim të evitimit të rreziqeve të shëndetit dhe jetës së qytetarëve. Me këtë projekt gjithashtu arrihet qëllimi i parandalimit të përhapjes së sëmundjeve infektive zoonozave, tërbimit me anë të vaksinimit dhe ekinokokoze me tableta.

**Neni 2
Financimi i Projektit**

Komuna e Mitrovicës Veriore dhe Fondacioni StrayCoCo dakordohen që të bashkë financojnë realizimin e këtij projekti në mënyrën dhe kushtet e përcaktuara në këtë marrëveshje.

**Neni 3
Kohëzgjatja e Marrëveshjes**

Marrëveshja lidhet në afat kohorë, nga dita e nënshkrimit deri më 12.08.2025

**Neni 4
Lokacioni dhe trajtimi**

Trajtimi i qenve endacak sipas kësaj marrëveshje bëhet në territorin e Komunës së Mitrovicës Veriore nga stafi profesionist i veterinarisë i Ambulancës Veterinare të cilën e përzgjedhë Fondacioni StrayCoCo.

**Neni 5
Obligimet e Përbashkëta të Palëve**

Komuna e Mitrovicës Veriore dhe Fondacioni StrayCoCo do ti mbulojnë shpenzimet e trajtimit veterinar, përfshirë kastrimin/sterilizimin për 500 qenë endacak, brenda afatit të përcaktuar në nenin 3 të kësaj marrëveshje. Në kuadër të këtij numri të qenve të trajtuar përfshihen edhe rastet e eutanazisë.

Neni 6



Obligimet e Komunës së Mitrovicës Veriore

- 6.1 Komuna e Mitrovicës Veriore do të participoj nga buxheti i saj për shërbimet veterinarë që do të kryhen për qenë endacak, në bazë të çmimeve të përcaktuar në nenin 8 të kësaj marrëveshje.
- 6.2 Komuna e Mitrovicës Veriore do të i inkurajojë qytetarët, pronarët e qenve që nuk kanë mundësi pagese për një konsultë veterinarë për ti sjellë qentë e tyre, veçanërisht qentë femra, në Ambulancën Veterinarë të cilën e përzgjedhë Fondacioni StrayCoCo për sterilizim falas, vaksinim dhe dhënien e tabletave antiparazit falas nga Fondacioni.
- 6.3 Komuna e Mitrovicës Veriore do të organizojë fushatë informuese të qytetarëve në lidhje me programin e Sterilizimit dhe kastrimit në vazhdim. Komuna e Mitrovicës Veriore i lejon OJQ-së SAPA të vizitojë shkollat dhe t'i mësojë fëmijët për mbajtjen e kafshëve shtëpiake dhe pronësinë e përgjegjshme të qenve.

Neni 7

Obligimet e Fondacioni StrayCoCo

Fondacioni StrayCoCo merr për obligim që nga stafi veterinar i Ambulancës Veterinarë së përzgjedhur "Mitro Vet Shpk", të i kryej këto shërbime veterinarë:

- 7.1 Kapjen e qenve endacakë
- 7.2 Trajtimin (kontroll, ushqim, vaksinim, dehelmentizim, identifikim, matrikul)
- 7.3 Kastrimi/sterilizim
- 7.4 Hospitalizimi (3 ditë tek meshkujt dhe 5 ditë tek femrat)
- 7.5 Vaksinimi i qenve me dy Vaksina, vaksinë polivalente dhe vaksinë kundër Tërbimit (rabies)
- 7.6 Tableta antiparazit për 500 qenë
- 7.7 Lëshimi në vendin e kapjes
- 7.8 Eutanazia për qentë e sëmurë dhe agresive (kryerja e procesit të eutanazisë),
- 7.9 Ambulanca Veterinarë që e përzgjedhë fondacioni, kontrollon dhe monitoron çdo qen endacak i cili duhet të ketë të dukshëm matrikulën në vesh që është i identifikuar dhe regjistruar se qeni është sterilizuar dhe vaksinuar dhe trajtuar siç duhet.
- 7.10 Çdo qen regjistrohet në një regjistër së bashku me një fotografi me matrikulë në vesh, me numër të dukshëm. Ky Regjistër i kontrollit rregullisht do të ju prezantohet fondacionit StrayCoCo dhe Komunës.

Neni 8

Kostoja financiare – çmimet e trajtimit

- 8.1 Në realizimin e këtij projekti Fondacioni StrayCoCo merr pjesë me mjete financiare prej 52 % ndërsa Komuna e Mitrovicës Veriore me 48 %.
- 8.2 Kostoja për këtë trajtim për secilin qenë është 64.00 € (gjashtëdhjetë e katër euro). Fondacioni StrayCoCo do të mbulojë koston për 33.00 € (tridhjetë e tre euro) dhe pjesa tjetër prej 31.00 € (tridhjetë e një euro) do të mbulohet nga Komuna e Mitrovicës Veriore
- 8.3 Për rastet e Eutanazisë do të paguhet 15 euro nga Komuna dhe pjesa tjetër prej 15 euro nga fondacioni StrayCoCo.
- 8.4 Përshkrimi dhe çmimet për shërbimet veterinarë që do të kryhen paraqitur në formë tabelare:

Nr.	Përshkrimi i shërbimit veterinar	Njësia	Çmimet	Pagesa kryhet nga:
1	Zënia/kapja e qenve endacak dhe vlersimi për gjendjen shëndetësore .	Krerë/copë	11.00€	Komuna
2	Kastrimi/Sterilizimi i qenve endacak.	Krerë/copë	33.00€	Fondacioni StrayCoCo

3	Trajtimi (kontroll,ushqim) identifikim i qenve endacak-matrikuj, vaksinim Hospitalizim (3 ditë meshkujve dhe 5 dite femrave) dhe Lëshimi i qenve endacak në vendin e zënies-kapjes.	Krerë/copë	20.00€	Komuna
4	Total		64.00€	./...

8.5 StrayCoCo zotohet se qentë me lëndime trupore si: këmbë të thyera, plagë ose me zgjebe, do të trajtohen, do të hospitalizohen deri në shërimin e tyre. Shpenzimet për trajtim dhe hospitalizimin e këtyre rasteve i mbulon fondacioni StrayCoco. (Trajtimi i lëndimeve dhe sëmundjeve të rënda do të bëhet vetëm nëse qentë adoptohen më pas dhe nuk lëshohen në rrugë. Rastet e veqanta do të trajtohen nga SAPA.)

Neni 9

Pagesa për shërbimet e kryera

9.1 Komuna do të kryej pagesat për shërbimet veterinarë të kryera sipas kësaj marrëveshje në baza tre mujore, pas dorëzimit të faturës bashkë me raportin me shkrim të nënshkruar nga menaxheri/mbikëqyrësi i komunës.

9.2 Pagesat do të realizohen nga buxheti i Drejtorisë për Shërbime Publike.

Neni 10

Ndryshimet dhe ndërprerja e marrëveshjes së mirëkuptimit

10.1 Me pëlqimin paraprak të palëve nënshkruese kjo Marrëveshje e Mirëkuptimit mund të ndryshohet dhe plotësohet.

10.2 Komuna mban të drejtën e ndërprerjes së pagesës së shërbimeve për këtë destinim në rast se konstaton se Fondacioni StrayCoCo nuk i përmbushë obligimet e veta nga kjo marrëveshje. Fondacioni StrayCoCo rezervon të drejtën të ndalojë projektin në rast se ndodhin helmime masive ose vrasje të qenve endacak.

Neni 11

Mbikëqyrja e Zbatimit të Marrëveshjes

Mbikëqyrjen e zbatimit të kësaj marrëveshje nga komuna do ta bëjë një zyrtar i komunës i cili do të caktohet me vendim të Kryetarit të Komunës, ndërsa nga pala tjetër përfaqësuesi caktuar prej saj.

Neni 12

Zgjidhja e mosmarrëveshjeve

Palët pajtohen që mosmarrëveshjet eventuale të i zgjidhin me mirëkuptim, të kundërtën çështja do të kalohet në Gjykatën kompetente.

Neni 13

Përdorimi i gjuhëve

Kjo marrëveshje është përpiluar në gjuhën Shqipe dhe gjuhën Angleze. Në rast të interpretimeve të ndryshme në ndonjë dispozitë të kësaj marrëveshje, gjuha shqipe do të mbizotëroj.



Neni 14
Numri i ekzemplarëve

Marrëveshja e mirëkuptimit është përpiluar dhe nënshkruar në tre (3) ekzemplar identik në origjinal, prej të cilëve dy (2) për komunën dhe një (1) për palën tjetër nënshkruese. Marrëveshja përmban 15 nene në katër (4) faqe A/4.

Neni 15
Hyrja në fuqi

Kjo marrëveshje të hyn në fuqi në ditën e nënshkrimit, ndërsa fillon të zbatohet nga data 12/08/2024.

Winterthur, 11/08/2024 dhe Mitrovicë Veriore, 12/08/2024

Fondacioni StrayCoCo



Z. Erdën ATIQ, Kryetar

Komuna e Mitrovicës Veriore

REPUBLICA E KOSOVES